



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

Nr. 1654 Prot

Peshkopi, më 17.05.2022

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.34

Datë 10.05.2022

“Për një shtesë në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR

.....
Adresa: Bulevardi "Elez Isufi", Peshkopi, Albania, nr. tel. & fax. 00355 218 229 37


Relacion shpjegues për miratimin e "Shpenzime për mbështetjen e festës lokale të Shën Kollit, Nja Selishtë"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", neni 54, shkronja k, "miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik" si dhe duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 "Për buxhetin e vitit 2022", i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022, në buxhetin e bashkisë Dibër është planifikuar nga drejtoria e shërbimeve publike "Blerje lubrifikantesh (vajrash) Bashkia Diber, viti 2022" kanë mbetur pa u përdorur 500,000 lekë nga procedura e prokurimit dhe kërkojmë që të përdoren për "Shpenzime për mbështetjen e festës lokale të Shën Kollit, Nja Selishtë" për mbështetje financiare në organizimin e festave lokale si mundësi për promovimin e turizmit në Dibër.

Përgjegjësi Sektorit Juridik
Elona Lusha


Drejtör Ekonomik
Lorenc Cibaku

Përgjegjëse Finance
Mensur Shehi





BASHKIA E PESHKOPË
1659 /
14/20/05/22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.453/1.prot.

Peshkopi, më 19.05.2022

Lënda : Per vendimin nr. 34, datë 10.05.2022 të Këshillit të Bashkisë Dibër

Drejtuar : BASHKISE DIBER

PESHKOPI

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.34, date 10.05.2022 "Për një shtesë në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022 Bashkia Dibër", vendosa :

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e respektimit të legjisllacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën e finances e probleme të ngjashme me to dhe respektimit të disipline financiare, veprime që kurdoherë janë përgjegjësi direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt-vendime të kësaj natyre.

PREFEKTI
Nexhibedin SHEHU

**BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

V E N D I M

Nr. 34 Datë 10/05/2022

“Për një shtesë në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 10.05.2022 me 18 vota pro, 0 kundër dhe 0 apstenim:

Vendosi:

- I.** Miratimin e shtesës të zërit të fondit të financimit për shpenzimin “Shpenzime për mbështetjen e festës lokale të Shën Kollit, Nja Selishtë” si më poshtë:
- II.** Të pakësohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. 1 Art. 602 500,000 lekë për “Blerje lubrifikantesh (vajrash) Bashkia Dibër, viti 2022”

Të shtohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. 1 Art. 602 500,000 lekë për “Shpenzime për mbështetjen e festës lokale të Shën Kollit, Nja Selishtë”
- III.** Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Turizmit, Sektori i Prokurimeve dhe Sektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

Kryetar Këshilli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Spektori i Financës

PROJEKT-VENDIM

Nr. 11 Datë 10/05/2022

“Për një shtesë në zërin e shpenzimeve operative të planifikuara për vitin 2022, Bashkia Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.15 datë 25.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.01 datë 13.01.2022, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin nr.54/1 prot. datë 21.01.2022:

Kërkojmë:

- I. Miratimin e shtesës të zërit të fondit të financimit për shpenzimin “Shpenzime për mbështetjen e festës lokale të Shën Kollit, Nja Selishtë” si më poshtë:
- II. Të pakësohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. 1 Art. 602 500,000 lekë për “Blerje lubrifikantesh (vajrash) Bashkia Diber, viti 2022”

Të shtohet :
Gr 0,0 Tit. 6260 Kap. 1 Art. 602 500,000 lekë për “Shpenzime për mbështetjen e festës lokale të Shën Kollit, Nja Selishtë”
- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Spektori i Turizmit, Spektori i Prokurimeve dhe Spektori i Financës pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

PËR BASHKINË DIBËR:

Përgjegjëse spektorit Juridik
Elona Lusha

Përgjegjëse Sekt.Arsimit, Kulturës e Turizmit
Valbona Kaloçi

Përgjegjëse Finance
Mensur Shehi

Drejtor Ekonomik
Lorenc Cibaku

KRYETARI BASHKISË
Rahim Spahiu